VENDIM
Nr.1577, datë 26.11.2008

PËR RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR NË SHQIPËRI TË TRUPIT TË TË NDJERIT PERIKLI TETA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Përballimin nga shteti të shpenzimeve të transportit, për kthimin në Shqipëri të trupit të ndjerit Perikli Teta, ish-Ministër i Mbrojtjes dhe oficer i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili ndërroi jetë, më 7 janar 2007, në Spitalin Ushtarak të Aviacionit, në Athinë, Greqi dërguar për trajtim dhe kurim mjekësor nga shteti.

2.Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t'i shtohet fondi, prej 4354 (katër mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) euro, i barasvlefshëm në lekë sipas kursit ditor të shkëmbimit, për ambasadën shqiptare, në Athinë, Greqi, për kryerjen e pagesës së shoqërisë së huaj të transportit.

3.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4.Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha